



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 65, datë 11.04.2022

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “BLUE 1”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/7 dhe 434/7-1 prot., datë 08.04.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”,

**Konstatoi se:**

- Në vijim të relatimit në Mbledhjen e Bordit të datës 11.04.2022, të Relacionit të protokolluar me nr. 434/7 prot., datë 05.04.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, lindi nevoja për të sqaruar me shoqërinë çështjet që kanë të bëjnë me:
  - fillimin e punimeve të centralit dhe çdo sqarim që lidhet me aftin e vlefshmërisë së licencës;
  - financimin e ndërtimit të centralit dhe nënshkrimin/depozitimin e marrëveshjes së financimit;

- pajisjen me certifikatë pronësie për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, për të cilat është bërë me dije se pagesa e këstit të fundit do të kryhet brenda muajit prill 2022.
- Në të tilla rrethana, për të mundësuar sqarimin e sa më sipër, vlerësohet shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**